

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 21-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 12.12.2025**

**Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

**Të punësuar nga Shërbimi Profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska, Sergej Todorovski.

**Të pranishmit e tjerë: /**

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 21-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 20-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 21.11.2025.
2. Propozim për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër operatorit Shoqërisë për tregri dhe shërbime "Total TV" SHPK Shkup për shkelje të nenit 141 të LShMAAV.
3. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës së pronësisë së SHTR TV "Shutel" SHPKNJP Shkup.
4. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës nën prapagun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike, shërbim - trajnim me temë "Zbatimi i standardeve në përgatitjen e specifikimeve teknike, definimi i kriterëve për përcaktimin e aftësisë".
5. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: marrja e hapësirës për publikimin e shpalljeve në gazetatat ditore.

6. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: kontroll i jashtëm i sigurisë dhe qëndrueshmërisë së rrjetit dhe portaleve të internetit të Agjencisë.
7. Propozim për miratimin e mjeteve financiare për rinovim të 2 (dy) qasjeve përdoruese në bazën elektronike të dispozitave të "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".
8. Të ndryshme.

## **Pika 1**

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së 20-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 21.11.2025, me tekstin e propozuar.

## **Pika 2**

Drejtori Trajčevski shpjegoi propozimin për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër operatorit, Shoqërisë për tregti dhe shërbime "Total TV" SHPK Shkup, për shkak të shkeljes së nenit 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Ai informoi se gjatë mbikëqyrjes së kryer të rregullt programore u konstatua se operatori ritransmeton shërbime programore që nuk janë të mbuluara nga çertifikata e regjistrimit të dhënë nga Agjencia. Meqenëse kjo është një shkelje e përsëritur, përkatësisht e dyta në vitin aktual, u propozua që Këshilli i Agjencisë të inicon procedurë kundërvajtëse kundër operatorit dhe urdhërojë shkyçjen e menjëhershme të kanaleve programore në fjalë.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore nr.11-5271/1 datë 4.12.2025 të Shoqërisë për tregti dhe shërbime "Total TV" SHPK Shkup dhe konstatoi shkelje të nenit 141 të LShMAAV.

Këshilli njëzëri konkludoi që kundër Shoqërisë për tregti dhe shërbime "Total TV" SHPK Shkup, të inicohet procedurë kundërvajtëse para gjykatës kompetente sepse nga mbikëqyrja u konstatua se Shoqëria për tregti dhe shërbime "Total TV" SHPK Shkup, e cila sipas notifikacionit nga Agjencia për Komunikime Elektronike mund të ushtrojë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datë 3.12.2025 për përdoruesit e saj ritransmetoi shërbimet programore "Happy", "Prva", "Tanjug", "Prva World", "Diva", "Nickelodeon", "Nick Junior", "KCN 1", "KCN 2", "KCN 3", "Prva Plus", "Prva Kick", "Sci Fi", "Club MTV", "MTV '80", "MTV Life" dhe "B92", të cilat nuk janë të mbuluara nga çertifikata për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, që është në kundërshtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente për operatorin e lartpërmendur.

### Pika 3

Në lidhje me vendimin e propozuar për ndryshimin e strukturës së pronësisë së SHTR TV "Shutel" SHPKNJP Shkup, drejtori Trajçevski informoi se transmetuesi në vitet e fundit është përballur me probleme në lidhje me kohën e pagesës së mjeteve ndaj Agjencisë për kompensim vjetor të lejes për transmetim televiziv. Ai kujtoi se vitin e kaluar leja për transmetim iu revokua, por pas ngritjes së procedurës para Gjykatës Administrative dhe pas pagesës së mjeteve të duhura, Këshilli miratoi Vendim për kthimin e lejes. Përveç kësaj, ai shpjegoi se transmetuesi vitet e fundit ka qenë në një situatë më të vështirë financiare.

Ai theksoi se është pozitive që kërkesat ligjore për ndryshimin e strukturës së pronësisë janë përmbushur dhe shprehu pritjen që pronari i ri do t'i kapërcejë problemet aktuale.

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, informoi se njoftimi për ndryshimin e strukturës së pronësisë është dorëzuar në Agjenci më 24 nëntor të këtij viti dhe se dokumentacioni i dorëzuar është i rregullt dhe i plotë. Ndryshimi i planifikuar ka të bëjë me tërheqjen e plotë të pronarit aktual të televizionit, personit fizik Antonije Stojçeski, dhe hyrjen e personit fizik Beadin Sulejmanovski si pronar i vetëm i televizionit. Me qëllim për të përcaktuar nëse ekzistojnë pengesa ligjore që ky person të paraqitet si transmetues, është kryer kontroll në të dhënat e Regjistrat Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe është konstatuar se pronari i ri i planifikuar, aktualisht është pronar i dy shoqërive tregtare. Të dyja shoqëritë janë të regjistruara me shifër veprimtarie në fushën e punimeve ndërtimore, që do të thotë se ky ndryshim nuk krijon përqendrim të paautorizuar mediatik. Duke pasur parasysh se ndryshimi i planifikuar nuk shkel dispozitat e Kapitullit 4 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, pra nuk çon në përqendrim të paautorizuar mediatik, propozimi është që Këshilli i Agjencisë të miratojë Vendim që do të lejojë ndryshimin e strukturës së pronësisë të televizionit "Shutel".

Këshilltarja Gordana Majnova pyeti nëse ndryshimi i kërkuar në strukturën e pronësisë të TV "Shutel" do të mbetet formati i pandryshuar i televizionit, përkatësisht nëse ai do të vazhdojë të transmetojë në format të përgjithshëm.

Udhëheqësja e Sektorit, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, sqaroi se pavarësisht ndryshimeve në strukturën e pronësisë së transmetuesve, formati i programit, cilido qoftë ai, nuk duhet të ndryshohet. Ajo theksoi se TV "Shutel" ka format të përgjithshëm dhe se ndryshimi i pronësisë nuk do të thotë që pronari i ri mund ta ndryshojë formatin e programit.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga, duke iu referuar shpjegimit, bëri një pyetje shtesë në lidhje me faktin se pronari i ardhshëm zotëron tashmë dy firma dhe pyeti se për cilat shoqëri(kompani) tregtare bëhej fjalë, me çfarë lloj veprimtarie merren dhe nëse dhe në çfarë mase kjo mund të kishte ndikim në politikën editoriale të medias.

Udhëheqësja, Davidovska Dovleva, shpjegoi se njëra firmë quhet Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime OTTOMAN PETROL SHPK Shkup, me veprimtari prioritare/shifra kryesore e të ardhurave është 43.39 – Punime të tjera ndërtimi, dhe tjetra është Shoqëri për ndërtimtari, tregti dhe shërbime GAMA GRADBA SHPKNJP Shkup, me veprimtari prioritare/shifra kryesore e të ardhurave është 43.350 – Punime të tjera ndërtimore. Ajo theksoi se këto janë veprimtari sipas Klasifikimit kombëtar të veprimtarive. Përveç kësaj, ajo theksoi se në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në Kapitullin 4, përcaktohen saktësisht veprimtaritë që nuk lejohen një person të kryejë njëkohësisht në veprimtarin radiodifuzive, siç janë, ndër të tjera, reklamim të agjencive dhe shoqërive për

produksin filmi. Veprimtaria e ndërtimit në fjalë, nuk paraqet pengesë ligjore për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga arriti në përfundimin se nuk kishte mundësi për ndikim të tepruar në formimin e opinionit publik, me të cilin udhëheqësja u pajtua dhe shtoi se një ndikim i tillë nuk mund të arrihet as në kuadër të zinxhirit të vlerës në produksionin mediatik dhe as në industrinë e reklamave.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim që lejon ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë tregtare me veprimtari radiodifuzive. TV "Shutel" SHPKNJP Shkup, me tekstin siç është propozuar në Vendim.

Me ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të SHTR TV "Shutel" SHPKNJP Shkup nuk krijohet përqendrim i palejueshëm mediatik sipas kuptimit të LShMAAV, përkatësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e nenve 34, 35 paragrafi 2 ose 38 të LShMAAV.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pas votimit, kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, uroi pronarin e ri të TV "Shutel" dhe i dëshiroi suksese në drejtimin e televizionit dhe në përmbushjen e plotë të detyrimeve ligjore.

#### **Pika 4**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës nën prapen e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike, për furnizim të shërbimit - trajnim me temë "Zbatimi i standardeve në përgatitjen e specifikimeve teknike dhe definimi i kriterëve për përcaktimin e aftësisë". Ajo sqaroi se bëhet fjalë për furnizim me vlerë deri në 1.000 euro në kundërvlerë në denarë, për shkak se në këtë rast nuk zbatohen dispozitat e Ligjit për furnizime publike. Gjithashtu, theksoi se lënda e furnizimit është shërbim për kryerjen e trajnimit mbi temën në fjalë, në kuadër të së cilës do të përfshihet dhe aspekti i implementimit dhe monitorimit të realizimit të kontratave për furnizim publik. Trajnimi do të jetë një ditor, do të mbahet në ambientet e Agjencisë, që është një zgjidhje më ekonomike, dhe pritët të realizohet në gjysmën e dytë të dhjetorit. Do të kryhet nga persona me çertifikim përkatës për trajnerë ose ligjërues nga fusha e furnizimeve publike. Në trajnim do të marrin pjesë 10 të punësuar nga shërbimi profesional, të cilët do të caktohen nga udhëheqësit e sektorëve dhe do marrin pjesë në përgatitjen e specifikimeve teknike për procedurat e furnizimit publik në kuadër të kompetencave të sektorëve të tyre. Qëllimi i zbatimit të këtij trajnimi është promovimi dhe përmirësimi i cilësisë së specifikimeve teknike në procedurat për furnizime publike, si dhe përmirësimi i cilësisë së monitorimit të realizimit të kontratave për furnizim publik. Zbatimi i këtij trajnimi rrjedh nga dy akte të miratuara nga Agjencia për vitin 2025. Akti i parë është Plani Vjetor për parandalimin e korrupsionit të Agjencisë për vitin 2025, i cili është miratuar vazhdimisht që nga viti 2021 dhe i cili, ndër të tjera, përfshin fushat e furnizimit publik, planifikimin e buxhetit dhe zbatimin e procedurave. Në kuadër të fushës për furnizim publik, nënfusha 1.2 - zbatimi joadekuat i procedurave të furnizimit publik, me masën 1 - forcimi i kapaciteteve të personave që përgatisin specifikime teknike, parashikohet të realizohet një trajnim i tillë, në të cilin do të marrin pjesë persona nga sektorët e përfshirë në përgatitjen e

specifikimeve teknike. Akti i dytë është Plan i Vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni i Agjencisë për vitin 2025, i cili, në fushën e furnizimit publik, identifikon rrezikun e kontrollit të pamjaftueshëm në monitorim, përkatësisht zbatimin e kontratave të furnizimit publik, si dhe nevojën për përfshirje më të madhe të të gjithë sektorëve në këtë proces. Me qëllim të zbatimit në mënyrë më ekonomike dhe efikase, dy trajnimet e planifikuara janë kombinuar në një trajnim të përbashkët, i cili në kuadër të tij do të përfshijë dy aspekte: zbatimin e standardeve në përgatitjen e specifikimeve teknike dhe avancimin e njohurive dhe aftësive për monitorim dhe zbatimin e kontratave të furnizimit publik. Përveç kësaj, u sqarua se ky shërbim nuk është parashikuar në Planin Vjetor për furnizim publik, pasi vlera e tij është nën pragun e vlerës dhe në këtë rast nuk zbatohen dispozitat e Ligjit për furnizim publik. Për këto arsye, shërbimi nuk është përfshirë në Planin Vjetor për furnizim publik. Mjetet për realizimin e tij janë parashikuar në Planin Financiar të Agjencisë. Si rregull, për procedurat vlera e të cilave është nën pragun e vlerës nuk parashihet procedurë e veçantë në përputhje me praktikën aktuale, Agjencia zbaton furnizime të tilla duke paraqitur kërkesë te drejtori për miratimin e mjeteve (fondeve) deri në 60,000 denarë, përkatësisht nën pragun për zbatimin e Ligjit për furnizim publik. Në rastin konkret është paraqitur një ofertë që është e pranueshme dhe ekonomike, duke marrë parasysh numrin e pjesëmarrësve në trajnim dhe cilësinë e ligjëruesve, të cilët janë trajnerë të çertifikuar dhe me përvojë të gjatë në fushën e furnizimit publik. Për këtë shkak, propozohet që Këshilli të pranojë propozimin e drejtorit dhe të japë miratim për zbatimin e trajnimit në fjalë.

Anëtar i këshillit Petar Xhurovski pyeti se kush do ta zhvillonte trajnimin.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrovska, u përgjigj se trajnimi do të mbahet nga Shoqata e Shërbimeve Konsulente "ACT" SHPK Shkup, dhe ligjëruesit do të jenë persona të njohur që punojnë në Byronë e Furnizimeve Publike. Ata janë trajnues me përvojë të gjatë, të çertifikuar për të kryer trajnime në fushën e furnizimeve publike.

Këshilltarja Cvetanka Minovska pyeti se kur i është paraqitur kërkesa drejtorit nga sektori dhe nga ku buron nevoja që trajnimi të realizohet në gjysmën e dytë të dhjetorit të këtij viti, përkatësisht nëse ka mundur të realizohet më herët. Pyetja e dytë lidhej me faktin se, megjithëse bëhet fjalë për furnizim publik me vlerë deri në 1.000 euro në kundërvlerë në denarë, nëse për një furnizim të tillë mund të zgjidhet kompani me vetëm një ofertë apo është e nevojshme të ketë më shumë oferta. Ajo theksoi se në materialet e dorëzuara ishte paraqitur vetëm një ofertë dhe pyeti nëse kishte aplikuar dhe ndonjë ofertues tjetër.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska, u përgjigj se kërkesa drejtuar drejtorit ishte paraqitur më 3.12.2025. Ajo shpjegoi se në përputhje me praktikën e mëparshme të Agjencisë, këto trajnime zhvillohen gjatë kësaj periudhe të vitit, kryesisht për shkak të përgatitjes së Planit Vjetor për parandalimin e korrupsionit dhe Planit Vjetor për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit për vitin 2026, gjatë së cilës bëhet një shqyrtim nëse aktivitetet e planifikura më parë janë zbatuar. Përveç kësaj, Mitrevska kujtoi se në periudhën e mëparshme Agjencia kishte një ngarkesë të shtuar pune, me fokus në monitorimin e zgjedhjeve lokale, të cilat kishin përparësi dhe ishin të lidhura me afate kohore, prandaj trajnimi është planifikuar të realizohet në gjysmën e dytë të dhjetorit. Në lidhje me një ofertë të paraqitur, ajo shpjegoi se në këtë rast nuk publikohet njoftim publik, por ftohen persona juridikë të veçantë që ofrojnë shërbim specifik. Bëhet fjalë për temë për të cilën numër i vogël kompanish organizojnë trajnime dhe kanë njohuritë e nevojshme, dhe gjithashtu ka numër të kufizuar të firmave konsulente që mund të ofrojnë ligjërues cilësorë. Prandaj, u pranua oferta nga ky organizator, për shkak të ligjëruesve të çertifikuar dhe çmimit ekonomik të ofruar.

Këshilltarja Cvetanka Minovska theksoi se në shpjegim thuhet se shërbimi ju bën thirrje firmave që ofrojnë këtë shërbim dhe pyeti nëse kjo do të thotë që firma e thirrur ishte e vetmja apo janë thirrur edhe të tjera.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska shpjegoi se kjo firmë ishte e vetmja që paraqiti ofertë, që është ofruar edhe në materialet për këtë pikë.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga shtoi se pyetja e Minovskës ishte nëse ishin kontaktuar dhe firma të tjera profesionale për zbatimin e trajnimit mbi këtë temë dhe, nëse janë kontaktuar, ato nuk kishin paraqitur ofertë për shkak të mungesës së interesit.

Udhëheqësja Mitrevska konfirmoi se u kontaktuan edhe firma të tjera, por ato nuk shprehën interes për të paraqitur ofertë dhe për të organizuar trajnim për shkak të mungesës së ligjëruesve të kualifikuar.

Këshilltarja Cvetanka Minovska e pyeti kryetarin e Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, nëse ai ishte njoftuar më parë për zbatimin e këtij trajnimi.

Kryetari Stefanovski u përgjigj se nuk ishte njoftuar nga drejtori, edhe pse në përputhje me Rregulloren e Punës duhej të ishte informuar.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli tha se materialet për këtë pikë nuk përfshijnë kërkesë për ofertë që do të buronte nga Agjencia, as për këtë firmë dhe as për firmat të tjera.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska shpjegoi se nuk ka kërkesë zyrtare sepse njoftimet u dërgohen në mënyrë elektronike tek firmat, ndërsa të interesuarit paraqesin ofertë, ose kontaktohen me telefon.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli theksoi se në seancat e mëparshme ka pasur furnizime për procedura nën pragun e vlerës, ku janë paraqitur disa oferta me çmime të ndryshme, dhe Këshilli i Agjencisë ka zgjedhur ofertën më ekonomike. Ajo mendon se edhe në këtë rast duhej të ishte ndjekur e njëjta procedurë.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska shpjegoi se në rastin konkret, nuk ishte paraqitur asnjë ofertë tjetër përveç kësaj.

Këshilltarja Vërzivolli pyeti gjithashtu për aktet e përmendura në shpjegimin e udhëheqëses Mitrevska - Plani Vjetor për parandalimin e korrupsionit dhe Plani Vjetor për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit të Agjencisë - kur ato u miratuan nga Agjencia.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska, shpjegoi se Plani Vjetor për parandalimin e korrupsionit të Agjencisë për vitin 2025 dhe Plani Vjetor për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit për vitin 2025 janë miratuar më 26.12.2025. Ajo sqaroi se këto akte janë miratuar nga drejtori i Agjencisë, në përputhje me urdhrin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komisionit Shtetëror për parandalimin e korrupsionit. Kjo do të thotë që Agjencia ka detyrimin t'i miratojë këto plane vjetore për parandalimin e korrupsionit dhe për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit. Ajo vuri në dukje se Plani Vjetor për parandalimin e korrupsionit është miratuar që nga viti 2021, dhe Plani Vjetor për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit që nga viti 2022, dhe se që atëherë këto akte miratohen në kontinuitet çdo vit.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli arriti në përfundimin se, siç e kuptoi, Agjencia ka obligim të detyrueshëm për t'i mbajtur këto trajnime për të siguruar harmonizim me aktivitetet e parashikuara në planet vjetore.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska, shpjegoi se Agjencia ka detyrimin të zbatojë këto plane vjetore, të cilat kanë korniza të përcaktuara dhe elementë dhe fusha të definuara. Furnizimi publik është identifikuar si një nga fushat me rrezik, ku ka rrezik më të madh korrupsioni, prandaj është planifikuar ky trajnim. Qëllimi është të sigurohet cilësi më e madhe në zbatimin e furnizimit publik, përmes përgatitjes së duhur dhe profesionale të specifikimeve teknike dhe monitorimit efektiv të zbatimit të procedurave për furnizim publik. Prandaj për këto arsye trajnimi është planifikuar si aktivitet.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli e pyeti udhëheqësen Cvetanka Mitrevska nëse materialet nga trajnimi në simpoziumin për furnizime publike, në të cilin ajo mori pjesë, ishin ndarë me kolegët që ishin planifikuar të merrnin pjesë në trajnimin e propozuar.

Udhëheqësja Mitrevska shpjegoi se simpoziumi ishte për temë tjetër. Ajo theksoi se furnizimi publik është fushë komplekse dhe përmban disa tema. Trajnimi synon konkretisht përgatitjen e specifikimeve teknike, me pjesëmarrjen e kolegëve nga sektorët që përgatisin këto specifikime. Për shembull, sektori i IT-së po përgatit specifikim teknik për furnizimet në fushën e tyre. Ajo shtoi se, megjithëse mori pjesë në trajnim, si juriste nuk posedon aftësi për të udhëhequr këtë trajnim ose për të ndihmuar pjesëmarrësit në pjesën praktike.

Këshilltari Vërzivolli pyeti nëse një ditë do të ishte e mjaftueshme për trajnimin e 10 pjesëmarrësve nga sektorë të ndryshëm.

Udhëheqësja Mitrevska u përgjigj se, megjithëse koha është e kufizuar, pjesëmarrësit do të marrin udhëzime bazë, dhe nga ana tjetër, dhe mjetet (fondet) janë të kufizuara.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli propozoi që mund të ishte më efektive nga ana e kostos blerja e "Udhëzuesi praktik për furnizimin publik", veçanërisht pasi në mënyrë elektronike ka ofertë për blerjen e librit, në vend që të mbahet trajnim një ditor.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska, shpjegoi se Agjencia tashmë e posedon këtë literaturë dhe shërbimi e përdor, por furnizimet publike janë shumë komplekse dhe trajnimi mundëson zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve konkrete që nuk mbulohen vetëm duke lexuar udhëzuesin. Ajo theksoi se kolegët nuk kanë kohë ose mund të mos jenë të motivuar mjaftueshëm për ta lexuar udhëzuesin, ndërsa në trajnim mund drejtpërdrejtë të bëjnë pyetje në lidhje me dyshimet ose mospërfutjet në përgatitjen e specifikimeve teknike. Mitrevska theksoi se ndërveprimi dhe ligjëratat gjatë trajnimit e bëjnë më efektiv sesa leximi vetëm i udhëzuesit, i cili, tashmë përdoret nga shërbimi, njësia për furnizime publike dhe nga ajo si udhëheqëse e sektorit.

Udhëheqësja e Sektorit për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit – Shef Kabinetit, mr. Dragica Ljubevska, shpjegoi se këto trajnime janë planifikuar bazuar në përvojën e deritanishme dhe nevojat e identikuara gjatë viteve. Ajo theksoi se kolegët tashmë punojnë në mënyrë aktive me furnizimet publike nga sektorë të ndryshëm, por gjatë punës lindin pyetje që kërkojnë një përgjigje më të detajuar, të cilën njësia për furnizime publike nuk mund ta japë, prandaj organizohen këto trajnime. Ljubevska theksoi se këto trajnime nuk paraqesin edukim fillestar ose hyrje në furnizimet publike, por kanë synim të caktuar, gjatë të cilave përpunohen dilemat dhe paqartësitë të identikuara gjatë vitit. Ajo theksoi se trajnime të tilla tashmë janë traditë në Agjenci dhe nuk mbahen për herë të parë. Ajo shtoi se gjatë përgatitjes së Planit Vjetor për vlerësim të rreziqeve dhe Planit Vjetor për parandalimin e korrupsionit, sektorët identifikojnë dobësitë dhe nevojat, prandaj ky trajnim bazohet në praktikën dhe përvojën e mëparshme në zbatimin e furnizimeve publike. Ljubevska theksoi se nuk është e njëjta të lexosh teorikisht një udhëzues dhe praktikisht të marrësh pjesë në trajnim, ku pjesëmarrësit

mund të bëjnë pyetje dhe të sqarojnë dilemat me trajnerë të certifikuar me përvojë disa vjeçare.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli propozoi që dhe anëtarë të Këshillit të përfshihen në këtë trajnim.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska sqaroi se në trajnim mund të marrin pjesë një grup prej 11 të punësuar.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, pyeti nëse anëtarët e Këshillit mund të përfshihen dhe, nëse është e mundur, propozoi që këshilltarja Vërzivolli të merrte pjesë.

Mitrevska konfirmoi se anëtar i Këshillit mund të përfshihej dhe përsëriti se grupi i trajnimit përbëhet nga 11 persona.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli u pajtua të merrte pjesë në trajnimin me temë "Zbatimi i standardeve në përgatitjen e specifikimeve teknike dhe definimi i kriterëve për përcaktimin e aftësisë".

Këshilli i Agjencisë, me dy abstenime nga anëtarët e Këshillit Cvetanka Minovska dhe Gordana Majnova dhe 5 vota "pro", miratoi që Drejtori i Agjencisë të marrë vendim për furnizim të shërbimit - trajnim me temën "Zbatimi i standardeve në përgatitjen e specifikimeve teknike, definimi i kriterëve për përcaktimin e aftësisë".

Për zbatimin e procedurës nën pragun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike, shërbim - trajnim me temën "Zbatimi i standardeve në përgatitjen e specifikimeve teknike, definimi i kriterëve për përcaktimin e aftësisë", mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

## **Pika 5**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit: marrja e hapësirës për publikimin e njoftimeve në gazetatat ditore. Ajo shpjegoi se gjatë vitit 2025, më 27.3.2025, pas një procedure të zbatuar paraprakisht në përputhje me Ligjin për furnizime publike, u lidhën dy kontrata për marrje të hapësirës për publikim të njoftimeve në gazetatat ditore - një për njoftime në gjuhën maqedonase dhe një për gjuhën shqipe. Pas lidhjes së këtyre kontratave, Agjencia duhej të publikonte akte në këto gazeta, të cilat, në përputhje me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Ligjin për marrëdhënie pune, obligohet t'i publikojë. Shumat e parashikuara në kontratat e mëparshme u shpenzuan dhe këto kontrata pushuan sëvlefshmi. Prandaj, Agjencia ka nevojë për procedurë të re për furnizim publik për publikimin e akteve në gazetatat ditore në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Kjo procedurë është parashikuar në Planin Vjetor për furnizim publik, ndërsa mjetet janë siguruar në Planin Financiar të Agjencisë. Duke pasur parasysh vlerën e parashikuar të furnizimit, do të zbatohet si furnizim me vlerë të ulët dhe do të fillojë me publikim në sistemin elektronik për furnizime publike. Të gjitha të dhënat e tjera mbi procedurën përfshihen në materialet e bashkangjitura.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga pyeti se cilat kriterë do të përdorë komisioni për furnizim publik gjatë zgjedhjes së mediave të shtypit në gjuhën maqedone dhe shqip.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska u përgjigj se kriteri i vetëm për zgjedhjen e ofertuesit është çmimi më i ulët.



Këshilltarja Zirjeta Jajaga pyeti nëse është marrë parasysh fakti që ka media që nuk shpërndajnë mjaftueshëm kopje në të gjithë territorin e Maqedonisë, si dhe nëse po shqyrtohet vetëm gazeta e shtypit që botohet gjashtë ditë në javë, apo merren parasysh edhe aspekte të tjera.

Udhëheqësja Mitrevska shpjegoi se, meqenëse bëhet fjalë për furnizim me vlerë të ulët, operatorët ekonomikë që do të aplikojnë duhet të tregojnë aftësinë e tyre për kryerjen profesionale të veprimtarisë. Për këtë qëllim, në ofertat e tyre është e detyrueshme që të paraqesin deklaratë se gazeta që botohet është gazetë ditore e shtypit që shpërndahet në territorin e Maqedonisë dhe botohet gjashtë herë në javë, me përjashtim të festave shtetërore në përputhje me Ligjin për Festat në Maqedoni. Nëse një deklaratë e tillë nuk paraqitet si shtojcë e ofertës, oferta do të refuzohet si e parregullt.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga pyeti nëse në këtë rast mjafton vetëm deklaratë me shkrim.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska, shpjegoi se deklarata jipet nën përgjegjësi morale, materiale dhe përgjegjësi penale, dhe komisioni e pranon si të rregullt, pasi organi kontraktues nuk është policia ose prokuroria. Ajo theksoi se çdo rast vlerësohet sipas deklaratave të paraqitura dhe dokumenteve të dhëna nga institucionet përkatëse. Gjithashtu në përgjithësi është e njohur se numri i gazetave ditore që botohen është i vogël në Maqedoni dhe dihet saktësisht se sa ditë në javë botohen. Prandaj, komisioni për furnizim publik, së bashku me njësinë organizative për furnizim publik, e monitorojnë këtë aspekt dhe i kushtojnë vëmendje saktësisë së deklaratave.

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi se Agjencia mban një regjistër të mediave të shtypit, por në përputhje me ligjin, mediat e shtypit nuk janë të detyruara ta informojnë Agjencinë për dinamikën e tyre të botimit - qofshin ato ditore, javore, mujore apo periodike. Prandaj, për realizimin e furnizimit, duhet të kërkohen deklaratë nga botuesit, pasi nuk ka mënyrë tjetër për të konfirmuar rregullsinë e botimit të gazetave. Nuk ka organ që mund t'u lëshojë certifikatë për këtë, përveç nëse botuesit nuk paraqesin deklaratë nën përgjegjësi materiale, morale dhe përgjegjësi penale.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga shtoi se, në përputhje me Ligjin për Mediat, vetë botuesit duhet t'u japin dy kopje të gazetës Bibliotekave Kombëtare dhe Universitare.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: marrja e hapësirës për publikimin e njoftimeve në gazetatat ditore.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: marrja e hapësirës për publikimin e njoftimeve në gazetatat ditore, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar), nr.05-3061/1 datë 21.7.2025, dhe fondet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

## **Pika 6**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit: kontroll i jashtëm i sigurisë dhe qëndrueshmërisë së rrjetit dhe portaleve të internetit të Agjencisë. Ajo shpjegoi se Agjencia ka nevojë për këtë shërbim për të identifikuar pikat e

mundëshme të dobëta në sistemin informativ-komunikues, veçanërisht në lidhje me respektimin e dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Qëllimi i furnizimit është të merren masa të mëtijshme për sigurimin e të dhënave personale që Agjencia përpunon në kuadër të sistemit të saj të informacionit. Furnizimi është parashikuar në Planin Vjetor për furnizime publike, dhe fondet janë siguruar në Planin Financiar të Agjencisë. Sipas vlerës së parashikuar, furnizimi do të zbatohet si furnizim me vlerë të ulët dhe do të fillojë me publikimin e njoftimit në sistemin elektronik për furnizim publik. Mitrevska shtoi se kriteri për dhënien e kontratës do të jetë raporti më i mirë ndërmjet çmimit dhe kualitetit, me një shpërndarje prej 50 pikësh për çmim dhe 50 pikë për kualitet. Të gjitha të dhënat për furnizim përmbahen në materialet e bashkangjitura për seancën.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: kontroll i jashtëm i sigurisë dhe qëndrueshmërisë së rrjetit dhe portaleve të internetit të Agjencisë.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: kontroll i jashtëm i sigurisë dhe qëndrueshmërisë së rrjetit dhe portaleve të internetit të Agjencisë, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar), nr.05-3061/1 datë 21.7.2025, dhe fondet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

## **Pika 7**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi propozimin për miratimin e mjeteve financiare për rinovimin e dy qasjeve të përdoruesve në bazën elektronike të të dhënave të dispozitave të "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Ajo shpjegoi se më 5 dhjetor të këtij viti, skadon vlefshmëria e këtyre dy qasjeve. Prandaj, drejtorit i është paraqitur kërkesë për sigurimin e fondeve për përdorimin e qasjeve për periudhë prej 12 muajsh. Agjencia tashmë ka edhe katër qasje të tjera në bazën elektronike të të dhënave, që mundëson shfrytëzim të zbritjes gjatë pagesës. Në vend të 16,000 denarë për një qasje, do të paguhet 11,500 denarë, kështu që çmimi total për këto dy qasje është 23,000 denarë. Mitrevska theksoi se, meqenëse përdoret shërbim nga "Gazeta Zyrtare", i cili është organ i kontratës me detyrim ligjor për publikim të ligjeve, këto furnizime përjashtohen nga dispozitat e Ligjit për furnizime publike. Kjo siguron vazhdimin e përdorimit të shërbimit.

Këshilltarja Gordana Majnova pyeti se për cilët punonjës janë parashikuar këto dy qasje përdoruese dhe për kë ofrohen katër qasjet e mëparshme.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska, u përgjigj se një qasje përdoruesi është parashikuar për të si udhëheqëse e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, dhe e dyta për udhëheqësen e Njesisë për çështje normative dhe juridike pranë të njëjtit sektor. Katër qasjet e mëparshme janë të shpërndara në mënyrë të tillë që tre janë për punonjësit e Sektorit për çështje juridike, dhe një për punonjës në Sektorin për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit. Mitrevska theksoi se këto qasje e lehtësojnë punën, pasi shpesh është e nevojshme të përdoren ligje të ndryshme. Është më e lehtë që qasja të jetë elektronike, në vend që të shtypen dokumente. Me këto qasje ndiqen të gjitha ndryshimet në ligje, dhe "Gazeta Zyrtare" gjithashtu ofron tekste të pastruara editoriale, që lehtëson zbatimin e ligjit dhe ndryshimeve të tij, sepse për shumë ligje dhe ndryshime nuk ka tekst të pastruar të përgatitur.

Këshilltarja Gordana Majnova propozoi që, sipas mendimit të saj, së paku njëri nga anëtarët e Këshillit duhet të ketë qasje në "Gazetën Zyrtare".

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska tha se nuk ka pengesë për t'i dhënë akses një përdoruesi tjetër.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, e mbështet propozimin dhe propozoi që Gordana Majnova të ketë qasje, me të cilën ajo u pajtua.

Mitrevska shpjegoi se për të caktuar një qasje të re, duhet të përgatitet materiali për seancën e ardhshme, pasi aktualisht të gjitha qasjet janë të destinuara për të punësuarit. Si alternativë, ajo propozoi një nga dy qasjet aktuale t'i jepet këshilltares Majnova.

Kryetari Stefanovski u pajtua që më i mirë është propozimi i dytë, përkatësisht që një nga dy qasjet aktuale t'i jepet Majnovës.

Udhëheqësja Mitrevska deklaroi se do t'ia lëshonte aksesin Këshilltares Majnova.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi që drejtori i Agjencisë të miratojë vendim me të cilin miratohen mjete financiare në shumë prej 23.000,00 denarë, me TVSH të llogaritur prej 18%, për rinovimin e 2 (dy) aksesëve të përdoruesve në bazën elektronike të të dhënave të rregulloreve të "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", për një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh.

Shuma e mjeteve për qasje në bazën elektronike të të dhënave të rregulloreve të "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" është parashikuar në Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025.

Drejtori dr. Zoran Trajčevski, në mënyrë procedurale, shpjegoi se nuk do të ketë ndryshime në vendimin për miratimin e mjeteve financiare në shumën prej 23.000 denarësh me TVSH të llogaritur prej 18% për rinovimin e dy qasjeve të përdoruesve në bazën elektronike të të dhënave të rregulloreve të "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" për periudhë prej 12 muajsh. Ai theksoi se nuk ka nevojë që Këshilli të votojë se cilët persona do t'i përdorin qasjet, por vetëm për zbatimin e vetë qasjeve.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska, shtoi se do të jetë e nevojshme të informohet "Gazeta Zyrtare" e RMV-së se kush do t'i përdorë qasjet, pasi çdo qasje është lidhur për kompjuter konkret. Në këtë rast, lidhja do të bëhet me kompjuterin e këshilltares Majnova. Ajo theksoi se kjo nuk do të reflektohet në tekstin e vendimit.

## **Pika 8**

### **Të ndryshme**

Këshilltarja Cvetanka Minovska pyeti për statusin e raportit tremujor të revizionit për maj, qershor, korrik dhe gusht, dhe nëse revizori i brendshëm ka afat të caktuar për përgatitjen e raporteve. Ajo gjithashtu pyeti nëse raporti është përgatitur, anëtarët e Këshillit mund ta marrin.

Drejtori, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi se revizori i brendshëm nuk përgatit raporte tremujore, por punon sipas programit vjetor për revizion të brendshëm, i cili parashikon revizionet që kryhen gjatë vitit. Ai informoi se nga shkurti deri në gjysmën e parë të gushtit, Agjencia nuk kishte revizor të brendshëm, sepse revizori i mëparshëm ishte zgjedhur në funksion tjetër shtetëror. Pas punësimit të revizorit të ri të brendshëm, revizionet janë vonuar. Deri më tani, është kryer një revizion, njëri është në fazën përfundimtare dhe për të cilin Sektori për çështje ekonomike duhet të japë mendim për vërejtjet e revizorit në draft- raportin. Revizori ka edhe dy auditime të tjera që duhet të përfundojnë deri në fund të vitit. Auditimi i përfunduar mund t'u dorëzohet anëtarëve të Këshillit, ndërsa raportet e mbetura do t'u dorëzohen kur të përfundojnë nga auditori i brendshëm.

Drejtori dr. Zoran Trajčevski shpjegoi se për këtë vit janë planifikuar katër auditime, të cilat auditori duhet t'i përgatisë deri më 31 dhjetor. Ai theksoi se për shkak të periudhës kur Agjencia nuk kishte të punësuar në atë vend pune, tani auditori po punon me aktivitete të shtuara.

Këshilltarja Minovska konfirmoi se kjo ishte pikërisht pyetja e saj dhe shtoi se pret që raportet e auditimit t'i dërgohen menjëherë pas përfundimit të tyre.

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit – Shef Kabineti, mr. Dragica Ljubevska, shpjegoi se raportet e auditimit do t'u dërgohen anëtarëve të Këshillit, por duhet të merret parasysh procedura për përgatitjen e tyre. Ajo theksoi se së pari përgatitet draft-raporti i auditimit, i cili nuk i dorëzohet personit përgjegjës, por sektorit kompetent ku është kryer auditimi. Qëllimi është në atë sektor të kapërcehen vërejtjet dhe rekomandimet e auditorit. Sektori ku identifikohen gjetjet përgatit plan të aktiviteteve dhe arrihet harmonizim me auditimin. Vetëm atëherë përgatitet raporti përfundimtar i auditimit, i cili i dorëzohet personit përgjegjës, në këtë rast drejtorit, dhe anëtarëve të Këshillit. Ajo theksoi se draft-raporti nuk dorëzohet, gjë që është në përputhje me rregullat e Ministrisë së Financave, por raporti përfundimtar do të dorëzohet kur të përgatitet.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Mr. Sasho Stefanovski**